

VENDIM
Nr. 415, datë 4.7.2018

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 8.12.2016, PËR ÇËSHTJEN “MOLLA KUNDËR SHQIPËRISË”
(KËRKESA NR. 29680/07)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 8.12.2016, për çështjen “Molla kundër Shqipërisë” (kërkesa nr. 29680/07).

2. Në zbatim të vendimit të GJEDNJ-së, të bëhet ekzekutimi me mjete të përshtatshme i vendimit nr. 00-2008-33, datë 11.1.2008, të Gjykatës së Lartë, të dhënë në favor të ankueses, znj. Frida Molla, për lënien në fuqi të vendimit nr. 173, datë 27.6.2006, të Gjykatës së Apelit Korçë, e cila ka vendosur detyrimin e Ndërmarrjes Zonale të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Korçë për të ndaluar punimet në pronën e paditëses Frida Molla, si dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme.

3. Ekzekutimi i vendimit të GJEDNJ-së, sipas pikës 2, të këtij vendimi, të bëhet nga Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Korçë.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria Rajonale e OSHEE sh.a., Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama